



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

## TË DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

<b>Emri I NSH-së</b>	N.SH. "VRESHTARIA" ("Ndërmarrja")
<b>Emri I Ndërmarrjes së re</b>	<b>Ndërmarrja e Re Vreshtaria 1 – Toka Bujqësore në Smaq SH.P.K.</b> ( "Ndërmarrja e Re")  Ofertimi për Ndërmarrjen e Re duhet të përfshij vetëm tokën bujqësore në Zonën Kadastrale Smaq, Komuna e Prizrenit.
<b>Vendndodhja</b>	Zona Kadastrale Smaq, Regjioni i Prizrenit
<b>Biznesi/Spektori</b>	Agrobiznes/Vreshtari
<b>Prodhimet</b>	Produktet në të kaluarën përfshinin varietete të ndryshme të rrushit të verës dhe të tryezës. Tani NSH-ja nuk është aktive dhe nuk ka prodhime.
<b>Tregu</b>	Ndërmarrja kryesisht ka mbuluar tregun ushqimor të Kosovës, duke i përfshirë verarët Kosovare si ajo e NBI Rahoveci, NBI Suhareka dhe "Kosovavera" në Krushë të Vogël, Komuna e Prizrenit.
<b>Konkurrenca</b>	Ndërmarrja tani kryesisht ballafaqohet me konkurrencën e prodhimeve prej importit dhe në një shkallë më të vogël nga agrobiznesi kosovar.
<b>Punonjësit</b>	Ndërmarrja ka 101 punëtorë. Prej tyre 17 janë aktivë dhe punojnë si roje. Ata janë të punësuar nga AKP-ja – Departamenti i Administrimit Direkt sepse NSH-ja prej vitit 2004 është nën administrimin direkt të AKM-së/AKP-së. Punëtorët e tjerë janë në pushim pa pagesë.
<b>Ndërtesat dhe tokat</b>	<b>Ndërmarrja e Re Vreshtaria 1 – Toka Bujqësore në Smaq SH.P.K.</b> Oferta për ndërmarrjen e re përfshinë tokën bujqësore (vreshta jo aktiv) me sipërfaqen e përgjithshme prej përafërsisht 18 ha 35 ari 20 m <sup>2</sup> (183,520 m <sup>2</sup> ). Kjo sipërfaqe prej 18 ha 35 ari 20 m <sup>2</sup> (183,520 m <sup>2</sup> ) është e regjistruar në emër të "PRONA SHOQËRORE-KIB PROGRES" :  Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-71813074-00151 e datës 13/10/2011; P-71813074-00728-1 e datës 12/10/2011 dhe P-71813074-00729-1 e datës 12/10/2011.
<b>Detyrimet që do të bartën</b>	<b>(1)</b> Detyrimet neto të NSH-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjokat, të cilat janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;  <b>(2)</b> Detyrimet e papaguara të NSH-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të


Informatat rreth Ndërmarrjes së Re të prezentuar në këtë Të Dhëna nuk janë të përligjura. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilët dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>

shitjes së subjektit të ri;

- (3) Detyrimet e NSh-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë shfaqur gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (4) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve (duke mos i përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punetoreve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punetore) e mbledhur gjatë rrjedhës normale të biznesit që:
- a) Eshtë mbledhur gjatë periudhës tre mujore që përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyrë në fuqi;
  - b) Që mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSh-së.

Asnjë obligim nuk do të transferohet në Ndërmarrjen e Re. Të gjitha obligimet do të mbeten në NSh. Nuk ka hipotekë mbi asetet të cilat do të privatizohen.

#### Foto inqizimi ajror i Ndërmarrjes së Re



#### Informatat

Departamenti I shitjes  
Agjencia Kosovare e Privatizimit  
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1255  
Fax: +381 (0) 38 500 400  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

#### Dokumentet e ofertimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit  
Rruga: Ilir Konushevc Nr:8  
10000 Prishtinë, Kosovë

Informatat rreth Ndërmarrjes së Re të prezentuar në këtë Të Dhëna nuk janë të përligjura. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në humnizimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme të informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>